



01/Nr. 6752/2020
Data: 22.09.2020

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e gjashtë -VI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.08.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Menduh Vlashi (Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtorë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Medin Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotje të Mjedisit), Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershori 2020.
4. Miratimi i propozim vendimit për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, mallra dhe shërbime dhe rezerva.
5. Miratimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit.
6. Shqyrtimi i propozim rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
7. Shqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2021.
8. Miratimi i propozim vendimit për plotësim ndryshimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve.
9. Miratimi i propozim vendimit për themelimin e Institucionit parashkollorë.
10. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2019-2020.
11. Shqyrtimi i informatës për korrje shirjet.
12. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- së bashku me materialin ua kemi përcjell një informatë rreth koronavirusi nga fillimi deri më tani. Ju të gjithë e dini që kemi pasur shumë persona të dyshuar të cilët kanë kërkuar ndihmën e parë në QKMF por ne raportojmë vetëm për ata persona që janë zyrtarisht të infektuar. Gjatë muajit gusht kemi pasur gjithsejtë nëntë raste pozitive të cilët janë testuar nga Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik. Përmes Instituti jemi njoftuar se pesë janë të shëruar dhe katër të tjera ende mbeten aktiv. Në muajin korrik vetëm të dyshuar të cilët ishin përmes QKMF janë 31 persona ndërsa për muajin gusht janë 21 persona të dyshuar. Në muajin korrik ish nëntë persona të infektuar. Nëse keni ndonjë pyetje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- ne kemi dhënë vërejtjet tona sa i përket pandemisë por në biseda private me qytetarë që kemi pasur pjesa dërmuese kanë potencuar që kanë simtoma të kovidit. A janë bërë kërkesa të vazhdueshme në nivelin qendrorë për me bërë teste për kovid sepse në mënyrë rutinore ka ndodhur puna e testeve që janë bërë të cilat u potencuan, mirëpo unë kam bindje që në Han të Elezit ka raste më shumë duke pasur parasysh që në QKMF trajtohen si të dyshuar për kovid. Është mirë të xhindet mënyra se si me vërtetuar se sa persona janë të infektuar me kovid në komunën tonë për shkak se menaxhimi do të jetë më adekuatë.

Florim Shkreta thekson:- si janë shpenzuar mjetet financiare për kovid dhe a janë shpenzuar të gjitha apo ka ende të pa shpenzuara.

Teuta Shkreta thekson:- në këtë informatë është paraqitur vetëm pesë përqind e punës që është punuar duke filluar nga kryetari i komunës, drejtoresha e shëndetësisë dhe stafit të QKMF-së. Të dyshuar janë 52 persona ndërsa të diagnostikuar me kovid janë 22 persona. Janë mjekët që i përcaktojnë si të dyshuar e jo individët por ka edhe gripe sezionale, mirëpo ka individë të cilët refuzojnë me shkuar me bërë testin. Personat e dyshuar fillimisht shkojnë në laborator për analiza pastaj e bëjnë një rentegen dhe pastaj nëse konstaton mjeku i rekomandon për me bërë testin.

Florim Shkreta thekson:- është e vërtetë që ka pasur persona të tillë që kanë refuzuar për me shkuar me bërë testin por a duhet dikush të merret me ata persona për shkak se si një lloj terrori kanë shfaqur në Han të Elezit dhe qytetarët e dinë që është me simptome të kovidit e bredh rrugëve sikur mos me pasur asgjë. Duhet këta persona të njoftohen nga shtabi që me u vetizoluar.

Rufki Suma thekson:- realisht ka numër shumë më tepër të dyshuar por unë potencova të dyshuar zyrtarisht të cilët janë kontrolluar nëpër mjekë specialistë të ndryshëm të cilët u kanë rekomanduar që shejat i keni të kovidit. Një pjesë e pacientëve nuk kanë pranuar që me bërë testin dhe me forcë nuk mundemi me i detyruar me shkuar por mjekët ju preferojnë që duhet të vetë izoloheni. Sa i përket shpenzimit të mjetave financiare nuk kemi pasur nga niveli qendrorë pore kuvendi ka miratuar vendimin në shumë prej 10 000 € me të cilat kemi blerë pajisje për nevojat e QKMF-së

Sead Vila thekson:- personat të cilët janë të infektuar me kovidë marrin terapi në QKMF dhe a do të ishte me mirë që stafi i QMKF me ju kryer shënimë në shtypit e tyre sepse unë e dërgoj një familjarë timin për ndonjë kontroll dhe mund të kem kontakte me ata persona dhe unë nuk e di se kush janë.

Medin Imishti thekson:- në QKMF e kemi ndarë një dhomë me dy shtretër që ju kemi dhënë terapi edhe personave të dyshuar edhe ata që janë pozitivë dhe shumica e terapisë janë antibiotikë që nuk guxon me ju dhënë në shtëpi sepse pacienti duhet të mbahet në kontroll të mjekut.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

3. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- shumica e vitit ka shkuar me pandemi dhe krahas pandemisë kanë vazhduar edhe aktivitete e tjera.

Nora Xhoni thekson:- e përshëndes raportin e kryetarit të komunës sepse për kundër pandemisë ecuria e punës ka vazhduar në nivel duke filluar nga takimet bashkëpunimet dhe marrëveshjet kanë vazhduar e si komunë nuk kemi pasur probleme sikur komunat e tjera që prej pandemisë kanë mbetur projektet mbrapa. Është për me u falënderuar bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm për ndihmat që u kanë dhënë familjeve të cilat kanë pasur nevojë. Komuna e Hanit të Elezit është shpërblyer për performance më të mirë dhe është për tu përshëndetur ky shpërblim.

Mehmet Ballazhi thekson:- këtë informatë e kam analizuar në detaile dhe ka disa pika që vetëm përsëriten më shumë në mënyrë teorike për punët të cilat janë kryer dhe disa që janë në procedurë, ndërsa tjerat janë vetëm përsëritle duke filluar prej rregullimit të kanalizimeve fekale nëpër disa lagje dhe çdo herë kam potencuar që duhet të përcaktohet. Nëse është kryer një projekt duhet të përcaktohet se në cilin vend është kryer dhe kostojë e projektit.

Florim Shkreta thekson:- a ka pasur ndonjë kriter për studentët që janë përzgjedhur për bursë për me i kryer studimet në kolegjin universum. Sanimi i rrëshqitjes te projekti Hani i Elezit –Gorancë në ç'farë periudhe kohore duhet të përfundon dhe inspektorët e komunës a kanë të drejtë për me i bërë inspektimet. Ndërtimi i sallës sporteve SHFMU “Veli Ballazhi” është shënuar që është në procedurë a në fakt është nënshkruar kontrata dhe pse nuk ka përfituar ofertuesi më i lirë për 38 000 €. Në cilat fshatra janë bërë shpime të puseve. A janë paguar shtesat për mjekët dhe infermierët që janë të kontraktuar nga shoqata “Islamik Relief”. Drejtoria për shëndetësi a mendon që situata me pandeminë është menaxhuar mirë.

Rufki Suma thekson:- sa i përket përzgjedhjes së studentëve nuk janë përcaktuar për shkak se përzgjedhja bëhet nga shkolla e mesme për nxënës që janë më të mirë dhe të cilët i kanë kushtet e vështira. Sanimi i rrëshqitjes është projekt qeveritarë dhe është planifikuar në vitin 2020 -2021 dhe për deri sa financohet prej nivelit qendrorë zyrtarisht ata e mbikëqyrin por inspektorët e komunës i kanë dhënë vërejtjet e tyre. Sa i përket ndërtimit të sallës sportive ka mundur të jetë gabim teknik. Për çështjen e fituesit të tenderit janë procedurat e prokurimit që i përcaktojnë fituesin dhe firmat kanë të drejtë me bërë ankesë dhe kanë bërë por e ka vlerësuar OSHP-ja dhe ja ka refuzuar. Shpimi i puseve nëpër fshatra është si kod i përgjithshëm por bëhet fjalë drejtë për së drejti në Pustenik.

Medin Imishti thekson:- mjekët dhe infermierët të cilët paguhen prej shoqatës “Islamik Relief” kanë marr shtesë vetëm një herë, ndërsa për muajin korrik edhe gushtë jemi në bisedime dhe do t'i shohim mundësit se në çfarë forme me i kompensuar. Sa i përket menaxhimit të situatës me pandeminë për herë të parë jemi përbaluar me një situatë të tillë dhe është e natyrshme që ka mundur me pasur defekte të vogla por me rëndësi kemi pasur një bashkëpunim të mirë me ministrinë dhe komunat e tjera për menaxhimin e pikës kufitare e cila ka qenë sfida më e madhe për neve.

Florim Shkreta thekson:- kontrata ne mes komunës dhe kompanisë që është duke i kryer punimet në shkollën fillor “Veli Ballazhi” është e nënshkruar me datë 04.08.2020 dhe nëse nuk i ka plotësuar kriteret ofertuesi i cili ka qenë më i lirë atëherë nuk ka mundur me i plotësuar kushtet edhe në fshatin Paldenicë që është duke i përfunduar punimet kompania. Ne jemi të vetëdishëm që virusi është i padukshëm dhe nuk dua ta fajesoj askënd por nuk është mirë me i shënuar gjërat në mënyrë ma të mirë që me mbetur pa koment kur të lexohen shkrimet që i keni përgatitur në raport. Në materialin që na është dërguar potencoitet që komuna ka krijuar

shtabin për menaxhimin pandemisë e në fakt disa persona të këtij shtabi e kanë pasur mundësin që me bërë gara me makina në periudhën kur qytetarët nuk kanë mundur me dal prej shtëpive. Është potencuar që qytetarët të cilët vijnë nga shtet që janë me kovid të karantinoren për një periudhë dy javore dhe nuk është përfillë sepse kemi pasur persona që kanë ardhur nga vendet më të prekura me kovid dhe kanë shëtitur lirshëm. Potencohejt që ekipet mjekësore i kanë identifikuar të gjithë personat e kthyer në Kosovë dhe unë mendojë që janë identifikuar por me vonesë. Personi i parë me kovidë me datë 09.04.2020 ekipet mjekësore i kanë rekomanduar për vetë izolim por edhe këtu nuk është respektuar rekomandimi mjekësorë dhe për këtë rast ishin në dioni edhe anëtarët e shtabit për shkak se e gjithë familja e tij vazhdimit kanë shëtitur pa asnjë pengesë. Është shënuar që familjet e karantinuara janë furnizuar me gjëra ushqimore por kemi pasur një rast te lagja Kurti që përmes fesbukut ka kërkuar ndihmë dhe komuna nuk është përkujdesur edhe për gjërat elementare duke filluar edhe për ujin. Instituti Kombëtarë i Shëndeti Publik të Kosovës rekomandon masat për anti kovid që nënkuption vazhdimin e menaxhimit të rekomandimeve, a në fakt shumë persona të dyshuar me kovid ose anëtarët e familjes kanë bredhur rrugëve pa ndonjë arsy e që në dioni kanë qenë të gjithë anëtarët e shtabit edhe të gjithë ata që thirren në emër të ligjit. Më shqetësuese është se në QKMF nuk i është dhënë ndihma një të moshatari mbi 70 vjet i cili ka kërkuar që ti epet infuzion dhe nga stafi i QKMF i është thënë se nuk kemi që të bëjmë shtretërit janë të zënë dhe kjo është shqetësuese.

Rufki Suma thekson:- në informatën e kovidit janë të specifikuara të gjitha dhe në raport apo informatë çdo herë shënohet ajo çka ndodhur. Sa i përket pagave shtesë drejtoresha e shpjegojë. Çështja e tenderit të sallës së sporteve kompania që është duke i kryer punimet te shkolla fillore “Kështjella e Diturisë” punimet është dashur me i kryer para tre muaje dhe tash është në ekzekutim të dënimit për shkak të mos kryerjes së punimeve në afat kohorë dhe kompani jo ma serioze deri më sot në komunën e Hanit të Elezit nuk ka pasur, është firmë jo serioze dhe nuk ka qenë e kompletuar në dokumente dhe për këtë arsy nuk është pranuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

4. Miratimi i propozim vendimit për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale , mallra dhe shërbime dhe rezerva.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- në bazë të ligjit të buxhetit kemi mundësi të bëjmë alokime dhe transfe në bazë të kërkesave që i kanë përcjell drejtoritë. Rialokimi dhe transferi i mjeteve në total është në shumë prej 262,812.30 € nga fondet 10, 21 në kategoritë ekonomike shpenzime kapitale, mallra dhe shërbime dhe rezerva sipas tabelave 4.1 dhe 4.2 të bashkangjitur këtij vendimi. Rialokimi i mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej 116,076.30 €. Transferi mjeteve nga kategoria rezerva në ate mallra dhe shërbime është në shumë prej 14,785.00 €, ndërsa në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej 131,951.00 €. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- rilaokimi i mjeteve tregon që nuk ka pasur planifikim të mirë të mjeteve dhe duhet me pasur kujdes në të ardhme se për këtë arsy ndodhin edhe rialokimet. Përveç asaj që ka ndodhë rialokimi janë gjërat e përsëritura siç ishin edhe në raportin që e diskutuan më herët.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për, 3 kundër (grupi parlamentarë i PDK-së).

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE NË KATEGORINË EKONOMIKE SHPENZIME KAPITALE , MALLRA DHE SHËRBIME DHE REZVARA

5. Miratimi i propozim vendimit pér themelimin e komisionit pér zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë tē rendit tē punës hapi diskutimin.,

Edon Curri thekson:- mandati i këshillave lokale ka përfunduar në muajin prill tē këtij vit. Pér shkak tē pandemisë nuk kemi mundur me zhvilluar procedura pér zgjedhjen e tyre. Këshillat lokale duhet tē zgjidhen në bazë tē rregullores së re dhe në bazë tē kësaj rregulllore kemi bërë propozimin pér formimin e komisionit.

Samire Curri thekson:- a do tē respektohet barazia gjinore në këtë komision dhe a do tē ketë përfaqësues tē shoqërisë civile.

Florim Shkreta thekson:- potencoher që deri në përzgjedhjen e administratorit tē ri do tē jetë administratori ekzistues dhe nëse potenconi që ju ka kaluar mandati si e sqaroni këtë çështje se a janë në funksion administratorët apo nuk janë.

Rufki Suma thekson:- administratorët e këshillave tē fshatrave janë funksional deri në zgjedhjen e administratorëve tē ri pér shkak se pandemia e ka ndërprerë. Në aspektin zyrtarë deri sa tē zgjedhën administratorët e ri komuna do tē bashkëpunon me administratorët tē cilët janë aktual.

Mehmet Ballazhi thekson:- pér anëtarë tē komisionin propozohet tē jetë edhe nga një përfaqësues i fshatit , mirëpo a do tē jetë nga udhëheqja e më hershme apo vetëm ndonjë përfaqësues i fshatit. A do tē propozohet emri i anëtarit tē komisionit nga shoqëria civile.

Kryesuesi thekson:- përfaqësuesi i fshatit zgjidhet aty pér aty.

Rufki Suma thekson:- prej ekzekutivit propozojmë drejtorin e administratës, ndërsa përfaqësuesin e shoqërisë civile do ta propozojmë ndër kohë.

Kryesuesi thekson:-ftojë grupet parlamentare që tē japid propozimet e tyre pér anëtarë tē komisionit.

Nora Xhoni thekson:- në emër tē grupit parlamentarë tē AAK-së pér anëtarë komisioni propozoj z.Ijni Bushi.

Sabedin Hasallari thekson:- në emër tē grupit parlamentarë tē LDK-së pér anëtarë tē komisionit propozoj znj. Samire Curri

Teuta Shkreta thekson:- në emër tē grupit parlamentarë tē VV-së pér anëtarë komisioni propozoj z.Akif Shkreta.

Mehmet Ballazhi thekson:- në emër tē grupit parlamentarë tē PDK-së pér anëtarë komisioni propozoj znj.Besarta Suma.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim pér këtë pikë tē rendit tē punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzéri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZEIT.

6. Shqyrtimi i propozim rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Laçi thekson:- deri më tani sa i përket orarit të punës kemi vepruar me vendimin i cili ishte i miratuar në vitin 2009 dhe në atë vendimi nuk ka qenë i përfshirë orari për të gjitha subjektet afariste. Rregullorja është hartuar së bashku me komisioni që është për hartimin e akteve nënligjore. Komisioni ka bërë edhe ndryshimin e orarit të punës së barnatoreve të cilët e kanë pasur në sezonin e verës prej orës 08:00 deri në ora 24:00. Në komisioni ishte i përfshirë edhe kryetari i komitetit të bizneseve i cili propozoj që barnatoret të punojnë me kujdestari 24 orë dhe këtë propozim e keni te neni 11 i propozim rregullores. Rregullorja është shqyrtuar në KPF dhe sot shqyrtohet në kuvend dhe votohet për debat publik dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- përveç asamblesë e cila jep kontribut në këtë rregullore besoj që edhe grupet e interesit do të japid kontribut. Sa i përket çështjes së barnatoreve është mirë që drejtoria donë me vendosë rregull dhe është mirë drejtoria të bashkëpunon me përfaqësuesit barnatoreve që edhe atyre të ju përshtate orari por edhe të shërbejnë për qytetarët

Florim Shkreta thekson:- është mirë që rregullore të ketë por duke marr parasysh situatën se janë dëmtuar bizneset dhe me vendosë rregullore për kufizim të punës mendoj që nuk është në momentin e duhur. Nëse rregullorja miratohet a mendoni me zbatuar apo mendoni me miratuar dhe në momentin që duhet të zbatohet ju me heshtur. Lokalet të cilat janë te kufiri nëse ua kufizoni punën ata dëmtohen shumë. Te çështja e gurëthyesve ju e dini se nëse kompania "Sharrcem" kërkon material ata duhet ditëve të vikendit apo edhe ditëve të pushimit të festave zyrtare me furnizuar. Unë mendoj që duhet të analizohen gjërat mirë e jo kjo rregullore me vlejt vetëm për disa biznese që me i dënuar e disa të tjera mos me i dënuar, e që mendoj që kjo nuk duhet të ndodhë sepse jemi vend i vogël.

Sead Vila thekson:- unë kam informacione se edhe më herët ka pasur rregullore për respektim të orarit të punës por sa është zbatuar në praktikë nuk e di. Unë jam në dakord se kjo rregullore duhet të konsultohet me përfaqësuesit e bizneseve e jo vetëm një përfaqësues i bizneseve me folur për gjitha bizneset sepse ai mund të bisedon vetëm për biznesin e vetë por duhet edhe bizneset e tjera të konsultohen.

Nora Xhoni thekson:- sa i përket barnatoreve gjatë pandemisë kanë funksionuar 24 orë dhe është ide e mirë që të bëhet edhe në të ardhmen.

Sevime Laçi thekson:- arsyaja e propozimit të kësaj rregullore është se e kam parë të arsyeshme që komuna ta ketë një rregullore sepse ka ankesa të ndryshme të qytetarëve dhe bizneseve sa i përket orarit të punës.

Sabedin Hasallari thekson:- unë kërkojë që një barnatore të punon 24 orë dhe orarin ta ketë një muaj sepse qytetarët e dinë se cila punon pra të ketë rrotacion në mes barnatoreve.

Rufki Suma thekson:- kjo rregullore ndoshta nuk mund të jetë e kënaqshme për të gjithë por ndahet me veprimtari të ndryshme dhe ata të cilat janë me nivel qendrorë duhet të harmonizohen edhe me nivelin lokal.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM RREGULLORJA PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

7. Shqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- kjo rregullore për çdo vit është dërguar në kuvend por në këtë vit nuk kemi pasur asnjë propozim nga bizneset që me ndryshuar këtë rregullore. Në konsulta me zyrën ligjore na ka rekomanduar që kur nuk kemi ndryshime vetëm kryetari i komunës merr vendim që e njëjtë rregullore me mbetur në fuqi, mirëpo pasi rregulloret i miraton kuvendi i komunës kemi propozuar që vendimi të merret në kuvend. Në vendim duhet të potencohet se për deri sa nuk kemi ndryshime të mbetet kjo rregullore në fuqi edhe për vitet e ardhshme.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I RREGULLORESË PËR TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE.

8. Miratimi i propozim vendimit për plotësim ndryshimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- me kalimin e viteve kemi vërejtur që kjo rregullore ka nevojë për me u plotësuar andaj kemi dhënë propozimet për plotësim ndryshim.

Mehmet Ballazhi thekson:- është propozuar që studentët e vitit të parë që e kanë regjistruar vitin në kontuinitet (pa shkëputje) nga shkolla e mesme te vlerësohen me 5 pikë, mirëpo edhe në KPF kam dhënë arsyet që të hiqet sepse është një diskriminim për studentët e tjerë për arsyen e ndryshme nuk ka mundur me regjistruar vitin e parë.

Menduh Vlashi thekson:- kuvendi vendosë sa i përket propozimeve por kur e kemi hartuar këtë rregullore synim të parë e kemi pasur që me i nxitur studentët për me mësuar dhe kemi dhënë përparësi notës mesatare. Studenti që regjistrohet për herë të parë në kontinuitet me qenë i barabartë me atë që regjistrohet pas katër viteve është jo shumë fer dhe arsyen nuk mundemi mi shënuar.

Mehmet Ballazhi thekson:- nëse më bind ekzekutiv për këtë pikë unë do ta votojë. Unë kam informata për një nxënëse që e ka kryer mësimin dhe ka probleme shëndetësore dhe nuk mundet me u regjistruar për shkak gjendjes shëndetësore dhe është diskriminuese nëse i ka minus pesë pik dhe për këtë arsyen kam propozuar që të hiqet. E përmenda vetëm një rast por ndoshta mund të ketë shumë raste.

Menduh Vlashi thekson:- raste të shpeshta ka që nëse nuk regjistrohen në këtë vit regjistrohen vitin tjeter apo ndoshta provon por nuk mundet me dhënë provimin. Në fillim potencova që për me marr bursën prioritet i kemi dhënë notës mesatare.

Rufki Suma thekson:- unë propozoj që pesë pikshi me u hekë krejt edhe pse nuk kam bërë ndonjë analizë por nuk qon fortë peshë.

Florim Shkreta thekson:- ka studentë shumë të shkëlqyeshëm por nuk mund të regjistrohen për herë të parë dhe kjo është diskriminim sepse nuk mund të regjistrohen për shkak të konkurrencës dhe nuk është mirë me ja humbë të drejtë dhe me ndëshkuar.

Sead Vila thekson:- sa i përket pikës 15.1.4 nëse mbetet kështu në rregullore është e turbullt formulimi por nëse është fjala që është diskutuar që studentët përfshirë arsyen nuk kanë mundur me u regjistruar në atë vit ju ka humbur e drejta. Nëse ndonjë studentë përfshirë arsyen shëndetësore apo që nuk ka mundur me u regjistruar dhe regjistrohet është mirë të hiqet pesë pikshi dhe përmu është e pranueshme sepse ka studentë që kanë vendosur me u regjistruar në atë drejtim dhe i humb një vit, dy apo tri vite deri sa të regjistrohet në atë drejtim që e donë. Çështja e suksesit të jetë shumë lartë ndërsa pikët anësore mos ta dëmtojnë suksesin e përgjithshëm të një studenti.

Kryesuesi thekson:- konstatojë se u dakord që pesë pikshi me u heqë dhe mos me u hedhë në votim. A ka edhe ndonjë diskutim përkështuar që rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE.

9. Miratimi i propozim vendimit për themelimin e Institucionit parashkollorë.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Menduh Vlashi thekson:- si ekzekutiv qe tri vite kemi parashtruar kërkesë në nivel qendrorë përfshirë hapjen e çerdhes por përfshirë se qeveritët njëra pas tjetrës nuk na kanë lejuar me shtuar numrin e punëtorëve dhe me rishikim të buxhetit na i kanë mundësuar 13 punëtorë në kuadër të çerdhes. Përfshirë me u hapur ky institucion na nevojitet një procedurë që besoj që brenda dy muajave do të kryhet. Në mesin e dokumenteve që na kërkohet përllicencim të objektit është edhe vendimi i kuvendit për themelim. Kërkoj që të miratohet propozim vendimi që ta kemi në Ministri të Arsimit përfshirë aplikuar.

Mehmet Ballazhi thekson:- këtë propozim vendim e përkrahim përfshirë se ka shumë kohë që e kemi pritur me themeluar këtë institucion. Besoj që objekti i plotëson kushtet sepse nuk e din gjendjen fizike të tij pas një kohe të gjatë dhe shpresojmë me filluar. Në bazë të numrit të fëmijëve të paraqitur a plotëson kushte dhe si parti demokratike jemi përfshirë do ta mbështesim këtë propozim vendim

Florim Shkreta thekson:- a është propozuar emri për themelimin e këtij institucionit.

Rufki Suma thekson:- pas themelimit duhet të emërtohet por duhet të shikohen procedurat se në çfarë forme.

Menduh Vlashi thekson:- këtë procedurë e kam shpejtuar përfshirë arsyen që mos të vonohemi me hapur çerdhen dhe është përcjell si material shtesë në KPF por siç e kërkon udhëzimi do të procedohet. Qëllimi ishte që ta procedojë në kuvend që me aplikuar në Ministri të Arsimit. E kemi hapur njohimin përfshirë regjistrim të nxënësve por ende nuk është bërë numri i mjaftueshëm dhe është shtyrë afati që do të bëhet.

Teuta Shkreta thekson:- është fillim i ri dhe duhet ta kapim hapin siç duhet dhe është çështje e ndishme edhe punësimi përfshirë me na ecur puna mirë edhe mbarë sepse fëmijët dërgohen në moshën e vogël në momentin kur i merr themellet e diturisë. Është mirë të kemi kujdes në punësimet e mënyrë që mos të dështojmë në numrin e fëmijëve.

Menduh Vlashi thekson:- është udhëzimi administrativ i cili e përcakton saktë se çka kërkohet dhe do të hapet konkursi dhe ata të cilët i plotësojnë kushtet do të pranohen.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim përkështuar që rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E INSTITUCIONIT PËRASHKOLLORË

10. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2019-2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Sabedin Hasallari thekson:- te shkolla e mesme dardania është shënuar që suksese pozitive ka treguar më shumë gjinia femërore. Te klasa e dhjeta tre notën mesatare e keni shënuar 6.28 dhe mendojë që është gabim teknik dhe duhet të përmirësohet.

Sead Vila thekson:- jemi të vetëdijshme se ishte një vit më ndryshe se vitet e kaluara sepse nga data 11 marsi është ndërprerë mësimi dhe janë gjet forma të ndryshme për mos me mbetur fëmijët pa e zhvilluar mësimin. Edhe pse na ka ndodhë kjo situatë momentale i përgëzoj të gjithë akterët duke filluar prej komunës dhe mësimdhënësit të cilët kanë bërë një punë të veçantë por edhe kontributi i prindërve, i fëmijëve dhe nxënësve që ju kanë përgjigjur platformave të ndryshme.

Menduh Vlashi thekson:- gabime teknike do të përmirësohen.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

11. Shqyrtimi i informatës për korrije shirjet.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:-materialin e keni pranuar dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

12. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Florim Shkreta thekson:- është mirë që të bisedohet me stafin e komunës që mos me i parkuar veturnat përbull postës apo përbullë komunës sepse qytetarët kanë nevojë me kryer ndonjë shërbim dhe nuk kanë ku me i parkuar veturnat.

Mehmet Ballazhi thekson:- a është ndërmarr ndonjë veprim sa i përket trafos dhe kanalizimit në Pustenik. Te lagja rruga Lepenci pjesa e bazenave që i ka shfrytëzuar kompania “Sharrcem” është mirë me i shikuar mundësitet buxhetore për me bërë park për fëmijë apo parking sepse nuk shfrytëzohen për nevoja të kompanisë “Sharrcem”.

Hanumshahe Dibrani thekson:- në rrugën e UÇK-së ka problem me çështje të ndriçimit për shkak se po ndërkrehen dritat.

Samire Curri thekson:- dua ta shfaqi si shqetësim për të gjithë banorët e komunës pickimin e mushkonjave në tërë territorin e komunës. Kërkoj të bëhet një intervenim më i shpejtë sepse mund të ballafaqohemi me një infektim masiv.

Rufki Suma thekson:-sa i përket trafo që u potencua vazhdimesht i kemi bërë presione dhe do të vazhdojnë. Çështja e kanalizimit mund të kryhet nëse pronarët dakordohen që i lëshojnë pronat. Nëse do të bëhet projekti me Bankën Botërore do të bisedojmë me Ministri të Mjedisit për shkak se prona është pronësi të tyre dhe në atë pjesë me bërë park apo diçka tjetër që është në interes të banorëve. Sa i përket ndriçimit mund të ndodhë që ka ndonjë ndërprerje të rrymës. Për çështjen e pickimit të mushkonjave ka qenë problem që nga e premtja e kaluar dhe mund të eliminohet nga shteti përmes aeroplanit që e bënë dezinfektimin. Sa i përket parkingjeve ju kam sugjeruar punëtorëve që mos me i parkuar dhe me shfrytëzuar parkingun që e kemi rregulluar mbrapa objektit të komunës.

Menduh Vlashi thekson:- për çdo vit bëjmë informatë me shkrim për fillimin e viti të ri shkollorë por në këtë vit gjasat janë minimale sepse materiali duhet të përgatitet në këtë javë, kurse fillimi i viti shkollorë është shtyrë me datë 14 shtatorë. Ministria e Arsimit ka hartuar një master plan që është specifikuar çdo gjë, mirëpo për shkak të rrethanave dhe kushteve në disa shkolla me kërkesë të SBASHK-ut do të fillon me datë 14 shtatorë. Si komunë jemi deklaruar që kemi qenë të gatshëm që me një shtatorë me filluar mësimi në shkolla.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendorit të komunës.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:20.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendorit
MSc. Qamush Brava

